



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

# Raporti përfundimtar

Shqyrtimi i Tetë i Tarifave të Energjisë Elektrike

SHTES8 (2014-2015)

Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike

## DEKLARATË

Ky Raport Vlerësimi është përgatitur nga ana e ZRR-s me qëllim të informimit të palëve të interesuara. Ai nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-s dhe nuk duhet të interpretohet si tillë.

24 Qershor 2014



## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Përditësimet vjetore dhe përshtatjet e rregullta .....</b>	<b>3</b>
<b>3</b>	<b>Struktura e këtij raporti.....</b>	<b>6</b>
<b>4</b>	<b>Bilanci Energjetik .....</b>	<b>6</b>
4.1	Prodhimi i ri i KEK Gjenerimit.....	6
4.2	Humbjet e Lejuara në nivel të transmisionit.....	7
4.3	Humbjet e lejuara në nivel të shpërndarjes.....	7
4.3.1	Caktimi i caqeve të humbjeve .....	8
<b>5</b>	<b>Kostot e Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike (WHPC) për Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (FPEE).....</b>	<b>11</b>
5.1	WHPC sipas SHTE7 dhe Cirkularitetet që dalin nga Rregullat.....	12
5.2	Çmimet e supozuara të Importit dhe Eksportit .....	12
5.3	S-faktori dhe norma e interesit për përshtatjet.....	13
5.4	Përshtatjet për kostot e lejuara dhe aktuale të blerjes së energjisë për vitin 2013.....	14



## **1 Hyrje**

Zyra e Rregullatorit të Energjisë aktualisht është në proces të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE) dhe Përshtatjet e Rregullta për Vitin e Dytë Relevant të SHTE7 të Shqyrtimit Tarifor për Gjeneratorët e Rregulluar (KEK), Operatorin Sistemit Transmisionit dhe e Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Kjo është hera e parë që ZRRE-ja i nënshtrohet një procesi të Përshtatjes së Rregullt me Rregullat e reja për vendosjen çmimeve, proces ky i cili mundëson kontrollin tarifor shumë vjeçar.

Ky raport paraqet qëndrimet e ZRRE-së për Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë për Vitin e dytë Relevant.

ZRRE ju ka dhënë mundësi të licencuarëve që të japin komentet në propozimet e dhëna nga ZRRE-ja në këtë Raport Vlerësimi. Qëllimi i këtij Dokumenti është që t'u komunikojë palëve të interesit qëndrimet e ZRRE-së lidhur me të hyrat maksimale të lejuara.

## **2 Përditësimet vjetore dhe përshtatjet e rregullta**

Në vitin 2013, ZRRE-ja ka kryer Procesin e Shqyrtimit Periodik (SHTE7) gjatë të cilit ka caktuar, Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për pesë Vitet Relevante të ardhshme për Gjeneratorët e rregulluar (KEK), Operatorin e Sistemit Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE) janë caktuar për një vit gjatë procesit të Shqyrtimit të Vlerave Hyrëse sipas Rregullës për Vendosjen e Çmimeve për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike.

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve e aprovuar nga ana e ZRRE-së thekson se me qëllim të kalkulimit të ndryshimeve të lejueshme në Të Hyrat Maksimale të Lejuara brenda secilit Vit Relevant duhet të kryhet procesi i Përshtatjeve të Rregullta. Kjo përfshinë përditësimin e humbjeve të lejuara për parashikimin e rrjedhjeve aktuale të energjisë, indeksin për kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, Lejimet e Zhvlerësimit dhe Kthimin e Lejuar në raport me inflacionin duke aplikuar faktorët e paracaktuar të efikasitetit për këta të licencuar. Procesi i Përshtatjeve të Rregullta ndryshon nga Shqyrtimi Periodik i tërësishëm gjatë të cilit ZRRE-ja shkon nëpër një shqyrtim të detajuar të Kostove të Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, humbjeve të lejuara dhe të faktorëve të efikasitetit dhe Programeve të Lejuara për Shpenzimet Kapitale. Gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE-ja vetëm në mënyrë mekanike bënë përshtatjen e ndryshimeve mes vlerave të lejuara dhe atyre aktuale nga që tanimë janë lejuar gjatë Shqyrtimeve Periodike.

Të Hyrat Maksimale të Lejuara për FPEE janë caktuar për një periudhë një vjeçare por Vlerat Hyrëse të cilat janë përdorur për llogaritjen e MAR-it të FPEE-it janë caktuar gjatë Shqyrtimeve të Vlerave Hyrëse dhe janë të vendosura për një periudhë pesë vjeçare. MAR-i FPEE-së rivendoset gjatë çdo Përditësimi Vjetor për të korrigjuar ndryshimet mes kostove të parashikuara dhe atyre aktuale nën apo mbi kthimin e MAR-it gjatë Vitit Relevant për shkak të ndryshimeve mes faturimit të parashikuar dhe aktual dhe nën apo mbi kthimin e MAR-it për shkak të ndryshimeve mes kostove të parashikuara



të shitjeve me shumicë të energjisë dhe atyre aktuale dhe kostove të parashikuara dhe atyre aktuale që barten, në varësi të ndonjë ndarje të disbalancës në kosto dhe të ardhurat nga eksporti në mes të FPEE dhe Konsumatorëve të rregulluar.

Gjatë Procesit të Shqyrtimit Periodik, ZRRE-ja ka përcaktuar nivelin e lejuar të kostove operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzimet kapitale të lejuara, faktorët e efikasitetit, jetëgjatësinë Ekonomike të Aseteve, faktorët e profilizimit dhe koston mesatare të ponderuar të kapitalit dhe normën e interesit për gjeneratorit e rregulluar, KOSTT dhe OSSH. Prandaj, niveli i përgjithshëm i këtyre lejimeve nuk është temë për diskutime gjatë procesit të Përshtatjeve të Rregullta. Sa i përket parimeve të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve, gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE-ja do të:

1. Caktoj indeksin për Kostot e Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes për të gjithë operatorët e licencuar për Faktorin e Efikasitetit i cili caktohet gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe për Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve për Konsumatorë (IHÇK) për të gjithë artikujt në Eurozonë;
2. Caktoj caqet e Disponueshmërisë për Gjeneratorët e Rregulluar;
3. Caktoj Ngarkesat e Energjisë dhe Ngarkesat e Kapacitetit për Gjeneratorët e rregulluar;
4. Përditësoj Kostot e Lejuara për Furnizim me Thëngjill (LGSCt) për Gjeneratorët e Rregulluar. Ky përditësim përfshinë kostot e paracaktuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, Zhvlerësimin dhe Kthimin e Lejuar për Mihjet duke përcjellë parimet e njëjta sikur për Gjeneratorët e Rregulluar. Kostot e paracaktuara për LGSCt përfshijnë ndryshimin mes kostove aktuale dhe të lejuara për furnizim me thëngjill gjatë Vitit paraprak Relevant të Periudhës Rregullative;
5. Përditësoj Kostot për Lëndët Tjera Djegëse (OTFct) për Gjeneratorët e Rregulluar duke përfshirë ndryshimin me kostove të lejuara dhe aktuale gjatë Vitit Relevant të parë të Periudhës Rregullative;
6. Llogaris Kostot e Shitjeve me Shumicë të Energjisë të cilat përfshijnë koston e energjisë së blerë nga Gjeneratorët e Rregulluar, nga Importet dhe Margjina e Shitjeve me Pakicë. Këto përditësime kanë për qëllim reflektimin e ndryshimeve mes kostove të lejuara dhe aktuale të blerjes së energjisë në Periudhën Paraprake Rregullative;
7. Caktoj Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSct) për Operatorin e Sistemit Transmisionit dhe Operatorin e Tregut dhe përditësimin e tyre duke përfshirë ndryshimin mes kostove të lejuara dhe atyre aktuale për Periudhën paraprake Rregullative të cilat mund të jenë rritur për shkak të ndryshimeve në kostot e shitjeve me shumicë të energjisë apo për shkak të ndryshimeve në rrjedhjen e energjisë elektrike në sistemin e transmisionit;
8. Përditësoj MAR-in për OST-n për të reflektuar të hyrat e gjeneruar përmes Mekanizmit për Kompensime Ndërmjet OST-ve;
9. Përditësoj MAR-in për OST për të reflektuar ndryshimet mes Të Hyrave të Lejuara dhe të Hyrave Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant paraprak (t-1);
10. Llogarisë Mbitaksën për Energjinë e Ripërtëritshme që do të shfrytëzohet për financimin e Fondit për Energji të Ripërtëritshme (FER) me qëllim të pagesës së Tarifave Nxitëse (Feed-in Tariffs) për Gjeneratorët e BRE të pranuar në Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE);
11. Caktoj Ngarkesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, Operatorin e Tregut dhe Operatorin e Sistemit;



12. Caktoj e Kostot e Lejuara nga Humbjet (LSSCt) për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe përditësimin e tyre duke përfshirë ndryshimet mes kostove të lejuara dhe aktuale nga humbjet për Periudhën paraprake Rregullative që mund të dalin për shkak të ndryshimeve në kostot e shitjeve me shumicë të energjisë apo për shkak të ndryshimeve në rrjedhjen e energjisë elektrike në sistemin e Shpërndarjes.
13. Përditësoj MAR-in e OSSH-s për të reflektuar ndryshimin në mes Të Hyrave të Lejuara dhe Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant paraprak (t-1);
14. Caktoj Ngarkesat për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes;
15. Llogaris Kostot e Lejuara të Shitjeve me Pakicë për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike që përfshijnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes së aktiviteteve të FPEE, kostot e korporatës, lejitimet e zhvlerësimit dhe kostot tjera të arsyeshme të FPEE;
16. Caktoj MAR-in e ri të FPEE duke përfshirë ndryshimin mes faturimit të lejuar dhe aktual gjatë Periudhës paraprake Rregullative;
17. Caktimin e Tarifave të reja për Shitjet me Pakicë për konsumatorët e rregulluar tarifor;



### 3 Struktura e këtij raporti

Raporti Konsultativ është i strukturuar si vijon:

- Seksioni 4 paraqet Bilancin Energjetik të supozuar nga ana e ZRRE-s për Vitin e dytë Relevant të Periudhës Rregullative;
- Seksioni 5 Kostot e Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike (WHPC) për Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (FPEE);

### 4 Bilanci Energjetik

Bilanci Energjetik paraqet një kontribut kyç në procesin e përcaktimit të tarifave dhe si i tillë ka ndikimin më të madh në koston e ofrimit të Shërbimeve të Rregulluara në sektorin e energjisë elektrike. Bilanci Energjetik në modelin e ZRRE-s ka shfrytëzuar kontributet nga Bilanci Energjetik i aprovuar nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) për vitin 2014. Bilanci Energjetik është konstruktuar duke përdorur qasjen poshtë-lartë, ku vlera e parashikuar e shitjeve në nivel të shpërndarjes është përdorur si pikë fillimi. Mandej, për të llogaritur sasinë e energjisë së kërkuar për hyrje në sistemin e shpërndarjes është përdorur përqindja e humbjeve të lejuara në rrjetin e shpërndarjes nga gjeneratorët e shpërndarjes. Kërkesa në nivel të transmisionit, humbjet dhe eksportet i janë shtuar konsumit të shpërndarjes. Ndryshimi mes vlerës rezultuese dhe gjenerimit vendor (Gjenerimi i KEK-ut dhe Ujmanit) paraqet vëllimin e importeve që kërkohen për të balancuar prodhimin dhe kërkesën për energji.

#### 4.1 Prodhimi i ri i KEK Gjenerimit

Gjatë periudhës konsultative ZRRE ka mbajtur takime të shumta me KEK për të shqyrtuar mundësinë e zhvendosjes së planit të remontit të Gjeneratorit A5 për vitin e tretë relevant. Ky remont ishte planifikuar të ndodhte gjatë Vitit të parë të Periudhës Rregullative por KEK nuk ka arritur të kryejë remontin sipas orarit të planifikuar. Kjo ka rezultuar që remonti i asaj njësie të shtyhet për vitin e dytë Relevant kur pritet të hyjnë në remont edhe njësitë e tjera gjeneruese. Zhvendosja nga funksionimi i këtyre njësive gjeneruese në të njëjtën periudhë kohore do të rezultonte në mungesë të konsiderueshme të prodhimit nga Gjeneratorët vendorë që rrjedhimisht do të ndikonte në rritje të ndjeshme të vëllimit të energjisë së importuar.

ZRRE ka propozuar që remonti i njësive A5 të shtyhet për vitin e ardhshëm Relevant në mënyrë që pjesëmarrja e gjenerimit vendor në këtë vit të jetë më e madhe. Kjo ka ndikuar që prodhimi vendor të rritet për 170 GWh në krahasim me vlerën e dhënë në Balancën e aprovuar të Energjisë. Gjithsesi ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara do të përshtaten përmes WHPC në Përshtatjet e Rregullta të vitit të tretë relevant.



## 4.2 Humbjet e Lejuara në nivel të transmisionit

Humbjet e Lejuara në Nivel të Transmisionit janë caktuar të jenë 1.8% të nxjerra gjatë Procesit të Shqyrtimit Periodik.

## 4.3 Humbjet e lejuara në nivel të shpërndarjes

Më 6 shtator 2012, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ka miratuar Parametrat Rregullator (Vendimin) të cilin ZRRE-ja do të duhej ta përdor si vlerë kontribute gjatë caktimit të Të Hyrave Maksimale të Lejuara për Periudhën e vijuese Rregullatore (2013-2017, duke përfshirë vitin e parë kalimtar në SHTE6 të Shqyrtimit Tarifor)<sup>1</sup>. Vendimi përcakton faktorët tjerë kyç siç është WACC, Lejimet për Borxhet e Këqija dhe Faktorët e Efikasitetit, niveli i Humbjeve në Shpërndarje (për Vitin tjetër Relevant 1+5 për Periudhën Rregullatore të ardhshme) të cilët i lejohen OSSH-s që ti rimbursojë përmes Tarifave të Rregulluara. Vendimi thekson se niveli i lejuar i humbjeve do të fillonte nga humbjet e realizuara në vitin 2011 të cilat do të zvogëloheshin për 3 përqind gjatë secilit në tri vitet e para të përcjella nga 2.5 përqind gjatë tri viteve pasuese.

Në aplikacionin për tarifa, KEDS-i argumentoi se niveli i humbjeve në nivel të shpërndarjes të cilat duhet të mbulohen në tarifat e SHTE8 (2014-2015) duhet të rishkruhen për të filluar nga niveli aktual i humbjeve të arritura nga ana e KEK-ut gjatë vitit të parë kalimtar duke zbritur tre përqind. KEDS shfaq argumentin e vet mbi bazën se KEK-u nuk ka arritur tërësisht zvogëlimin e tre përqindëshit të humbjeve, ashtu siç edhe është dashur të bëhet, prandaj KEDS do të duhet të zvogëlojë humbjet për tre përqind, sipas Vendimit të ZRRE-s, plus ndryshimin mes caqeve të caktuara nga ZRRE-ja (3% të pikëve) dhe të arriturave aktuale të KEK-ut gjatë vitit paraprak (1.1% pikë).

ZRRE-ja nuk ka marr qëndrim përfundimtar lidhur me çështjen e rivendosjes së humbjeve. Vlera e caqeve ka ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e tarifave prandaj nga ZRRE-ja kërkohet që të konsultojë të gjitha palët e interesuara para se të merr qëndrim lidhur me këtë çështje<sup>2</sup>. . Vendimi për humbjet e lejuara është marrë para procesit të privatizimit dhe ndryshimi i Vendimit mund të interpretohet si ndryshim i kushteve sipas të cilave ishte kryer një proces konkurrues i ofertimit.. Prandaj, ZRRE-ja duhet të konsultojë palët e interesuara relevante duke përfshirë edhe Njësinë e KEDS-it Pas Privatizimit për të marrë mendimin e tyre lidhur me këto çështje. Deri në përfundimin e këtij procesi konsultativ, ZRRE-ja do të vazhdojë me aplikimin e Vendimit 399 dhe ka caktuar caqet e humbjeve duke zbritur tre përqind nga vlera e aplikuar gjatë Vitit Relevant paraprak siç është sqaruar në seksion me poshtë.

---

<sup>1</sup> Vendimi 399 i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është në dispozicion në faqen e internetit të ZRRE-s ([http://ero-ks.org/Vendimet/English/2012/D\\_399\\_2012.pdf](http://ero-ks.org/Vendimet/English/2012/D_399_2012.pdf))

<sup>2</sup> Neni 26, paragrafi 1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë kërkon që ZRRE-ja të ndërmerr dëgjim publik për çështjet me ndikim të madh në tregun e energjisë elektrike duke përfshirë të gjitha çështjet që lidhen me tarifat.



#### 4.3.1 Caktimi i caqeve të humbjeve

Vendim 399, me rastin e aplikimit të caqeve të humbjeve, nuk bënë ndarje mes humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe furnizimit e pafaturuar. Duke aplikuar caqet e reduktimit të humbjeve prej 3% për të gjitha humbjet do të nënkuptonte atë se OSSH-ja të zvogëlojë humbjet nga energjia e pafaturuar në një fushë mbi të cilën nuk ka kontroll. Prandaj ZRRE-ja do të aplikojë vetëm cakun prej 3% në shumën e humbjeve teknike dhe komerciale.

Gjatë llogaritjes së humbjeve të lejueshme në nivel të shpërndarjes për Vitin e parë Relevant të Periudhës Rregullatore, ZRRE-ja ka bërë këtë dallim duke zbritur 3% nga niveli i humbjeve të lejuara në nivel të shpërndarjes gjatë SHTE6. Sidoqoftë, gjatë llogaritjes së humbjeve në nivel të shpërndarjes për Vitin e Parë Relevant, ZRRE-ja ka ndryshuar edhe mënyrën e llogaritjes së humbjeve në shpërndarje. Humbjet e lejuara teknike dhe komerciale sipas SHTE6, të caktuara në 30.4%, ishin llogaritur si raport i humbjeve totale teknike dhe komerciale ndaj kërkesës totale që përfshinte edhe energjinë e furnizuar të pafaturuar:

$$\text{Humbjet e Lejuara} = 30.4\% = (\text{HT} + \text{HK}) / (\text{HT} + \text{HK} + \text{FPF} + \text{KSH})$$

Ku

HT = Humbjet Teknike

HK = Humbjet Komerciale

FP = Furnizimet e Pafaturuara

KSH = Kërkesa në Shpërndarje

Humbjet e lejuara teknike dhe komerciale sipas SHTE6 ishin 1,399.2 GWh.

Sipas SHTE7, ZRRE-ja ka llogaritur caqet e humbjeve duke zbritur 3 përqind nga niveli i lejuar prej 30.4% në SHTE6. Rezultati i caktimit të humbjeve ishte caktuar të jetë 27.4%. Mirëpo, mes SHTE6 dhe SHTE7, ZRRE-ja kishte ndryshuar edhe mënyrën e llogaritjes së caktimit të humbjeve. Humbjet e lejuara të llogaritura nga ZRRE-ja prej GWh ishin barabartë me 27.4% por vetëm pas zbritjes së furnizimeve të pafaturuara nga emëruesi:

$$\text{Humbjet e lejuara (SHTE7)} = 27.4\% = (\text{HT} + \text{HK}) / (\text{HT} + \text{HK} + \text{KSH})$$

Sikur llogaritja e humbjeve të bëhet njëjtë sikur gjatë SHTE6 atëherë do të rezultonin në humbje të lejuara efektive nga ZRRE-ja për Vitin e parë Relevant gjatë SHTE7 prej 26.2%. Shkalla e rezultatit prej 1,227 GWh do të ishte 1,308 GWh sikur ZRRE-ja të përdorte të njëjtën metodologji për llogaritje të humbjeve sikur gjatë SHTE6.

Në një Letër Konsultative që i është dërguar operatorëve të licencuar, ZRRE-ja bëri me dije faktin se mes SHTE6 dhe SHTE7 e kanë ndryshuar metodologjinë e llogaritjes së humbjeve dhe kjo gjë ka qar në një lejim të paqëllimtë më të vogël të humbjeve në OSSH sipas SHTE7. ZRRE-ja bëri shqyrtimin e caktimit të humbjeve por ka vazhduar të aplikojë qasjen se caku duhet aplikuar vetëm për humbjet teknike dhe komerciale dhe se këto duhet të llogariten si një raport mes këtyre humbjeve dhe





kërkesës së përgjithshme në shpërndarje duke përjashtuar furnizimet e pafaturuar meqë kjo energji nuk hyn në sistemin e shpërndarjes. Për të arritur vlerën e njëjtë të humbjeve të lejuara prej 1,308 GWh, ZRRE-ja ka rritur humbjet e lejuara në nivel të shpërndarjes në 26.6%. Caqet e humbjeve për Vitin e dytë Relevant ishin llogaritur duke zbritur tre përqind nga kjo vlerë e lejueshme e duke rezultuar kështu në një nivel të humbjeve të lejuara prej 25.6%.

Duke përdorur bilancin energjetik të aprovuar për shitjet e pritura për vitin 2014 dhe duke vazhduar nga ai përmes humbjeve në nivel të shpërndarjes, vlera e energjisë e cila futet në sistemin e shpërndarjes për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar ishte llogaritur të jetë 4,495.4 GWh. Kërkesat për furnizim në nivel të transmisionit (Ferronikeli, Sharrcem dhe Trepça), eksportet e energjisë elektrike, konsumi i LOMAG-ut dhe humbjet në nivel të transmisionit së bashku arrijnë shumën prej 1,608 GWh. Gjenerimi i KEK-ut, Ujmani dhe gjeneratorët e vegjël të kyçur në nivel të shpërndarjes pritet që së bashku të prodhojnë 5,653.3GWh. Ndryshimi mes konsumit dhe prodhimit do të mbulohet përmes importit në vlerë prej 450.3 GWh. Bilanci energjetik i llogaritur nga ZRRE-ja është përmbledhur në tabelën në vijim:



Tabela 1 2014 Bilanci Energjetik

Bilanci Energjetik		SHTE7 Lejuar	SHTE7 Letra Sqaruese	SHTE7 Aktual	SHTE8 (2014-2015) Lejuar
KEK Gjenerimi		5,592.0	5,592.0	5,877.5	17 5,525.0
Kosova A	GWh	1,848.0	1,848.0	2,014.0	1,929.0
Kosova B	GWh	3,744.0	3,744.0	3,863.4	3,595.95
Gjeneratorët e Kyçur në Transmision					
HC Ujmani	GWh	80.0	80.0	99.4	82.0
Konsumi i kyçur në Transmision		621.9	621.9	487.1	617.1
Ferronikeli	GWh	527.0	527.0	403.2	526.7
Trepca	GWh	94.9	94.9	84.0	27.1
Sharrcem	GWh				63.3
Konsumi tjetër në nivel të Transmision		295.0	295.0	287.1	283.1
Konsumi në Miniera	GWh	140.0	140.0	128.5	138.0
Furnizimi për Kosovën A nga Transmisioni	GWh	72.0	72.0	107.2	53.2
Furnizimi për Kosovën B nga Transmisioni	GWh	83.0	83.0	51.4	91.9
Humbjet në Transmision	%	1.8%	1.8%	1.7%	1.8%
	GWh	111.2	112.6	110.3	109.0
Hyrjet e Energjisë në sistemin e Transmisionit		6,177.0	6,254.5	6,491.9	6,057.2
Eksporti	GWh	492.0	492.0	857.0	599.0
Prodhimi Total	GWh	5,672.0	5,672.0	5,976.9	5,607.0
Importi	GWh	505.0	582.5	521.4	450.3
Kërkesa për Energji për mbulimin e konsumit (ngarkesës) në Transmision	GWh	1,520.1	1,521.5	1,741.6	1,608.2
Kërkesa për Energji për mbulimin e konsumit (ngarkesës) në Shpërndarje	GWh	4,656.9	4,733.1	18 4,750.3	19 4,449.1
Gjenerimi në Shpërndarje					
Gjenerimi i kyçur në Shpërndarje	GWh	35.0	49.0	43.9	46.3
Wind Power Sh.A	GWh				
Konsumi në Shpërndarje	GWh	4,691.9	4,782.1	4,794.2	4,495.4
Humbjet në Shpërndarje dhe energjia e pa faturuar					
Humbjet teknike dhe komerciale	%	27.4%	28.6%	32.5%	25.6%



	GWh	1,227.5	1,308.5	1,485.9	1,098.2
Furnizimi i pa faturuar	%	4.52%	4.43%	4.55%	4.69%
	GWh	212.0	212.0	218.2	211.0
Humbjet totale	GWh	1,439.5	1,520.5	1,704.1	1,309.2
Shitjet te konsumatorët fundor	GWh	3,252.4	3,261.6	3,090.1	3,186.2

## 5 Kostot e Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike (WHPC) për Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (FPPE)

Ky seksion i Raportit Konsultativ paraqet qëndrimet e ZRRE-s lidhur me Kostot e lejuara të Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike (WHPC) të cilat Furnizuesit Publik me Energji Elektrike (FPPE) lejohen t'i mbulojë përmes tarifave të rregulluara. Sipas nenit 13 të Rregullës për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike, Kostot e lejuara të shitjes së energjisë me shumicë duhet të përmbajnë:

- Kostot e lejuara me shumicë të kapacitetit (WHCC) janë ato kosto të ndërlidhura me pagesën e ngarkesave të kapacitetit për kapacitet gjenerues vendor, i cili kontraktohet për qëllime të garantimit të sigurisë së furnizimit dhe ka të bëjë me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar;
- Kostot e lejuara të energjisë me shumicë (WHEC) që përbëhen nga:
  - Kostot e blerjes së energjisë elektrike nga gjenerimi vendor;
  - Kostot e importit të energjisë elektrike;
  - Kostot e eksportit të energjisë elektrike (si kosto negative) të cilat i nënshtrohen një faktorit ndarës të eksportit;
  - Kostot neto të debalancit, që i nënshtrohen faktorit ndarës të debalancit.
- Marzhën me pakicë që do t'i sigurojë FPPE-së kthim të arsyeshëm për kompensimin nga rreziku i supozuar gjatë ofrimit të shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar.
- Kostot e Kapitalit punues i cili do të llogaritet si 1/12-ta e shumës së kostove të lejuara me pakicë, kostot e lejuara të energjisë me shumicë, kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë dhe kostot që barten.

Faktori ndarës i eksportit për momentin është caktuar të jetë 100% që nënkupton se të gjitha të hyrat nga eksporti i energjisë elektrike janë përjashtuar nga llogaritjet dhe i faturohen konsumatorit (si kosto negative). Për momentin nuk ka kosto për shkak të debalancit prandaj, kostot neto të debalancit nga llogaritjet është caktuar të jetë zero.



## 5.1 WHPC sipas SHTE7 dhe Cirkularitetet që dalin nga Rregullat

Kostot e lejuara të energjisë me shumicë, siç është definuar në Rregullën për Vënien e Çmimit të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike, nxjerrin një numër të cirkulariteteve me të cilat duhet marrë gjatë modelimit të llogaritjeve.

Një nga këto cirkularitete ngritët për shkak të zbritjes së humbjeve nga të hyrat nga WHPC. Paragrafi 5 i nenit 13 të Rregullës për Çmimet e FPEE-së thekson atë se të hyrat që kanë të bëjnë me shitjen e energjisë OST-së dhe OSSH-së duhet të zbriten nga kostoja e lejuar e energjisë me shumicë. Megjithatë këto të hyra janë produkt i vëllimit të humbjeve të lejuara (në GWh) dhe kostot mesatare të ponderuar të blerjes së energjisë të shprehura në €/MWh. Kjo e fundit varet nga kostot e lejuara të energjisë me shumicë që varet nga të hyrat e FPEE nga humbjet. Kjo paraqet një cirkularitet meqë të hyrat nga shitja e energjisë varen nga WHPC dhe anasjelltas.

Çështje tjetër që ngritët ka të bëjë me faktin se të hyrat nga Gjeneratorët e Rregulluar (pjesë e komponentës WHEC të WHPC) përfshijnë kostot nga pagesat për Operatorin e Sistemit (OS) që paguhet nga ana e Gjeneratorit të Rregulluar. Pagesat për OS varen nga humbjet në transmision ndërsa këto varen nga Kostot Mesatare të Ponderuara nga Blerjet e Energjisë Elektrike (WHEA) që varen nga Kostot e Blerjes së Energjisë e të cilat varen nga Të Hyrat nga Gjeneratorët e Rregulluar duke përfshirë edhe Pagesat për OS. Kjo paraqet një cirkularitet të mëtejshëm.

Në një Shkresë Sqaruese, ZRRE-ja, përveç tjerash, kishte sqaruar se ajo kishte ri-llogaritur komponentin e WHPC të MAR-it duke zbritur të hyrat e realizuara nga shitjet e humbjeve për OSSH-n dhe TSO-n dhe duke përjashtuar Pagesat për OS nga MAR i Gjeneratorëve të Rregulluar. Kjo vlerë është përfshirë si një e hyrë në këtë Vit Relevant për të iu shmangur cirkularitetit.

## 5.2 Çmimet e supozuara të Importit dhe Eksportit

Në Pjesën 1 të Procesit e Shqyrtimeve të Rregullta për “Aplikimin e Çmimit të Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike”, KEDS ka ofruar parashikimin e vlerave të importit dhe eksportit për 2014.


Çmimi i lejuar për import për vitin 2014 ka qenë 70 €/MWh ndërsa çmimi i realizuar i importit për vitin 2013 i raportuar nga ana e KOSTT-it është 62.18 EUR/MWh. KEDS propozon që ZRRE-ja duhet të vazhdojë lejimin e çmimit të importit prej 70 €/MWh meqë, sipas KEDS-it, ky çmim është llogaritur në bazë të sasive të realizuara dhe ndryshimeve të pritura të çmimit në rajon. KEDS propozon edhe atë që çmimi i parashikuar për eksport për vitin 2014 duhet të caktohet duke u bazuar në çmimin aktual të eksportit për vitin e kaluar në 24.90 €/MWh, çmim ky i cili është më i ulët se vlera aktuale e raportuar nga ana e KOSTT-it prej 28.25 €/MWh. Si duket KEDS ka aplikuar qasje kontradiktore në llogaritjen e çmimit për importe dhe eksporte meqë nuk është e qartë se pse presin që çmimi për eksporte të zvogëlohet ndërsa ai për importe të rritet gjatë vitit 2014.

Në harmoni me praktikën e mëhershme, ZRRE-ja ka konsultuar bazën e të dhënave të Berzës Evropiane për Energji Elektrike për të kuptuar trendin e çmimit të energjisë elektrike në tregjet



Evropiane. Posaçërisht, të dhënat e Phelix Base Futures<sup>3</sup> sugjerojnë se çmimi mesatar i energjisë elektrike për vitin paraprak (04/2013 – 04/2014) ka pasur rënie prej rreth 15%. Ky trend i rënies është evident në çmimet aktuale të importeve gjatë tremujorit të fundit të 2013 krahasuar me ato në tremujorin e parë të vitit 2013 të paraqitura në Figurën 1 më poshtë.

**Figura 1 importet dhe eksportet 2013**



Nuk ka dëshmi për të mbështetur kërkesën e KEDS-it se çmimi i importit të energjisë elektrike duhet të rritet gjatë vitit 2014 derisa çmimet e eksportit do të duhej pësuar rënie. Përkundrazi, të dhënat e EEX-it sugjerojnë se ky trend ka rënie. Sidoqoftë, për të ju shmangur shqetësimeve të mundshme në rrjedhjen e parasë për caktimin e WHPC për 2014, ZRRE-ja do të caktojë një çmim për importet dhe eksportet i cili është i përafërt me vlerat aktuale për vitin 2013. Prandaj çmimet e supozuara për importet e energjisë elektrike për 2014 janë caktuar të jenë 60 €/MWh ndërsa çmimet e supozuara për eksportet e energjisë elektrike janë caktuar të jenë 30 €/MWh.

### 5.3 S-faktori dhe norma e interesit për përshtatjet

Sipas Shtojcës 1, nenit 2.1 të Rregullës për Çmimet e FPEE-së, norma e interesit që aplikohet për MAR-in e FPEE në çdo vit relevant llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatorit gjatë Azhurnimeve Vjetore të cilat reflektojnë preminë e pagueshme nga ana e operatorit të licencuar për huat afatshkurtra. Kjo ndryshon nga parimi i aplikuar në Rregullat tjera për Vënien e Çmimit<sup>4</sup> ku vlera e S caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe mbahet konstante gjatë gjithë Periudhës Rregullatore.

<sup>3</sup> <https://www.eex.com/en/market-data/power/derivatives-market/phelix-futures#!/2014/03/27>

<sup>4</sup> Në fakt Rregulla për Vënien e Çmimit për Gjenerim, Transmision dhe Shpërndarje



ZRRE-ka ka rivendos vlerën e S e aplikueshme për përshtatjet e Furnizuesit Publik me Energji Elektrike si në vijim:

Norma e Kreditimit të Kosovës e marrë nga Buletini Mujor për Statistika i Bankës qendrore të Kosovës, tabela 14.2 (ODC Normat Efektive të Kamatave – normat kreditore të interesit)<sup>5</sup>. Vlera e marrë paraqet normën kreditore për investimet afariste për kreditë deri në 1 vit. Kjo vlerë, për janar 2014 është 13.08%.

Norma finale e kamatës për përshtatjet paraqet vlerën për janar (13.08%) duke zbritur EURIBOR-in për janar (0.537 – 1-vit EURIBOR-i për janar 2014) + 0.598 (norma aktuale e EURIBOR) = 13.14%.

#### **5.4 Përshtatjet për kostot e lejuara dhe aktuale të blerjes së energjisë për vitin 2013**

Gjatë secilit Azhurnim Vjetor, ZRRE-ja bën përshtatjen e Kostove për Shitjen me Shumicë të Energjisë për FPEE-n për ndryshimet mes kostove të parashikuara dhe atyre aktuale të energjisë gjatë vitit paraprak. Kosto totale të lejuara të blerjes së energjisë për vitin 2013 ishin 169.2 milion € ndërsa ato aktuale të shkaktuara nga FPEE-ja ishin 155.8 milion €. Ndryshimi prej -13.3 milion€ kthehet prapa krahas normës së interesit të aplikuar të specifikuar në Paragrafin 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës për Çmimet të FPEE-s.

---

<sup>5</sup> <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2014/MSB%20no.%20149.%20english.pdf>



Tabela 2 Përmbledhje e llogaritjes së Kostot e lejuara të energjisë me shumicë (WHPC)

Wholesale Power Purchase Costs		ETR7 Allowed	ETR8 Allowed
<b>Domestic generation</b>			
KEK Generation	€/MWh	27.0	25.3
	€000s	150,957	139,535
HPP Ujmani	€/MWh	27.5	27.5
	€000s	2,200	2,255
Distribution-connected generation (average)	€/MWh	43.8	43.8
	€000s	1,533	2,028
<b>Imports</b>			
Contracted imports	GWh	505.0	450.3
	€/MWh	70.0	60.0
	€000s	35,351	27,017
<b>Exports</b>			
Contracted exports	GWh	492.0	599.0
	€/MWh	28.0	30.0
	€000s	13,776	17,970
<b>Power purchase costs</b>			
KEK Generation	€000s	150,957	139,535
Other domestic generation	€000s	3,733	4,283
Imports	€000s	35,351	27,017
<b>Total power purchase costs</b>	<b>€000s</b>	<b>190,041</b>	<b>170,835</b>
Exports	€000s	-13,776	-17,970
Subsidies	€000s	-11,500	0
WHEC + WHCC	€000s	164,765	152,865
<b>Retail Margin</b>			
Retail Margin	%	3%	3%
Retail Margin costs	€000s	4,488	4,586
<b>WHPC</b>	<b>€000s</b>	<b>169,253</b>	<b>157,451</b>
WHPCat-1 - WHPCft-1	€000s		-13,384.0
It	%		13.14%
(WHPCat-1 - WHPCft-1)*(1+It)	€000s		-15,142.8
<b>WHPCf</b>	<b>€000s</b>	<b>169,253</b>	<b>142,309</b>
<b>Weighted Average Power Purchase Cost (WHEA)</b>	<b>€/MWh</b>	<b>30.2</b>	<b>27.3</b>